

“SHKOLLA DHE ARSIMI NË KOMUNËN E KAÇANIKUT”

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SOCIOLOGJISË**

NGA

SABRIJE AHMETAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

PRISHTINË

JANAR, 2022

REZYME

“SHKOLLA DHE ARSIMI NË KOMUNËN E KAÇANIKUT”

Mentori:

Prof. Dr. SHEMSI KRASNIQI

Studentja:

Sabrije Ahmetaj

Ky hulumtim ka për bazë të analizoj dhe krahasoj rolin e arsimit dhe shkollave gjatë viteve 90-ta e deri sot, të analizohen dhe studiohen vështirësitë dhe sfidat me të cilat është përballur sistemi i arsimit kosovar, veçanërisht ai në komunën e Kaçanikut.

Duke marrur parasysh rëndësinë e studimit të arsimit gjatë periudhës 1990-1999, studim synon të ofrojë një analizë në rrugën e saj drejt tejkalimit të rrethanave të vështira të së kaluarës dhe përpjekjes për standarde më të mira evropiane e ndërkombëtare. Detyrat e hulumtimit janë të krahasohen çështjet që lidhen me shkollat dhe arsimin prej viteve 90-ta e deri tani, të grumbullohen të dhënat përmes instrumenteve dhe të prezentohen rezultatet e fituara, të analizohen dhe të studiohen vështirësitë dhe sfidat gjatë viteve të arsimit kosovar, të nxirren përfundimet dhe të jepen rekomandime rreth kësaj çështje.

Hulumtimi u realizua nëpërmjet metodës teorike dhe përshkruese, teknikë hulumtuese u përdor anketa dhe intervista, ndërsa instrumente të hulumtimit janë pyetësori për nxënës dhe mësimdhënës, në nivelin shkolla e mesme e ulët dhe shkolla e mesme e lartë, në komunën e Kaçanikut dhe rrethinën e saj.

Duke pasur parasysh hulumtimet dhe studimet e deritashme në vendin tonë, rreth arsimit dhe shkollave gjatë periudhës së vështirë nëpër të cilën ka kaluar edukimi dhe arsimimi në Kosovë, është e nevojshme të bëhen më shumë studime për të zbuluar dhe ofruar fakte për opinionin e gjerë.

Ky punim masteri përmban hyrjen, dhe katër kapituj

Në strukturën e punimit kam paraqitur pjesën hyrëse dhe historikun e arsimit në Komunën e Kaçanikut. Punimi në strukturën e tij përmban gjithashtu edhe katër kapituj, duke përfshirë këtu rezultatet e hulumtimit, përfundimin dhe rekomandimet.

Pas hyrjes është pjesa e metodologjisë ku përfshihen qëllimi, detyrat, metodat dhe instrumentet e hulumtimit. Në këtë hulumtim janë përdorur të dhëna prej burimeve primare dhe sekondare po ashtu informacionet, gjegjësisht të dhënat, janë të siguruara nga intervista dhe pyetësorët. Pra përveç intervistave dhe pyetësoreve që janë realizuar, janë përdorur edhe metoda të analizës teorike dhe përshkruese. Prej instrumenteve të metodologjisë së hulumtimit është përdorur metoda e intervistimit dhe anketimit dhe kjo metodë e intervistimit më shumë është e bazuar në pyetësorë me pyetje të tipit të mbyllur dhe të hapur. Në fund është bërë analiza e intervistave dhe anketimit dhe janë realizuar me programin Excel.

Kapitulli i parë: në këtë kapitull kam përshkruar historikun e gjuhës shqipe dhe zhvillimin e arsimit në Kosovë nëpër etapa të ndryshme, sistemi paralel i arsimit në Kosovë (1990-1999), sistemi dhe struktura e arsimit në Kosovë, shkollat shqipe gjatë okupimit serb.

Kapitullin e dytë: përfshin historikun dhe themelimin e Kaçanikut, shkolla dhe arsimit në Komunën e Kaçanikut, dhuna dhe terrori serb në Komunën e Kaçanikut dhe procesi mësimor në shtëpi-shkolla në Kaçanik.

Kapitulli i tretë: përfshin organizimin dhe zhvillimin e arsimit pas luftës, reformat në arsim, sfidat e sistemit arsimor në Komunën e Kaçanikut dhe aplikimi i kornizës së kurrikulës në arsim.

Kapitulli i katër: përmban analizën e të dhënave dhe rezultatet duke përfshirë: rezultatet socio-demografike, statistikave përshkruese si dhe analizat statistikore. Rezultatet e studimit janë të paraqitura në mënyrë tabelare, histograme dhe përshkrimi narrativ i të gjeturave. Në këtë kapitull janë përfshirë gjithashtu edhe rekomandimet të cilat mendojmë se do të shërbejnë si udhërrëfyes për hulumtimet e ardhshme në fushën e arsimit në Kosovë.